



Pranuar / Dorezuar Prilimjenoi/Prilidato Received/Delivery	29-04-2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinitica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	2061/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Anr.259/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.259/2021 të datës 08.04.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga “Dëshmorët e Ponushecit”, Nr. 5 në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. 199/2021 të datës 11.03.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër Anr.259/2021 e datës 08.04.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr. 199/2021 i datës 11.03.2021 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi në bazë të Vendimit nr. 17/15 të datës 23.11.2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka qenë i emëruar në pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë për një mandat tre (3) vjeçar. Pas përfundimit të mandatit respektivisht mos vazhdimit të tij, ankuesi më datë 16.02.2021 ka parashtruar tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme kërkesë për sistemim në pozitë sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 11.03.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 199/2021 me të cilin ankuesin e ka emëruar në pozitën Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshëm në Inspektoratin e Punës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ankuesi më datë 16.03.2021 përmes e-mailit ka kërkuar nga Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të rishqyrtohet vendimi sepse nuk përputhet me përgatitjen time profesionale.

Pasi nuk është rishqyrtuar vendimi i lartcekur, ankuesi kundër tij, më datë 08.04.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:1674/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për dëmtim në karrierë sepse pozita që më është ofruar nuk i përket përgatitjes sime profesionale, po ashtu nëpër institucione ka pozita të lira të cilat i përshtaten përgatitjes sime profesionale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 15.04.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Me datën 27.05.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.04.2021 me Nr. Prot:1674/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 17/15 të datës 23.11.2017 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Diplomën e datës 23.08.2003; Kërkesën për sistem e datës 16.02.2021 nga ankuesi; Kërkesën për rishqyrtim të vendimit i datës 16.03.2021 nga ankuesi; E-mailin e datës 12.03.2021 nga _____ për ankuesin; Vendimin me Nr. 199/2021 të datës 11.03.2021 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Dëshmi nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Akt Emërimin e datës 27.10.2014 për aneksin; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme; E-mailin e datës 16.03.2021 nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 23.04.2021 dhe 21.04.2021 nga _____ për _____ E-mailin e datës 30.10.2020 nga _____ për _____ Njoftimin lidhur me pozitën e kategorisë së lartë drejtuese i datës 28.08.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm i MPB-së; Njoftimin e datës 05.10.2020 nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Konkursi për pozitën Drejtor i Departamentit për Zhvillim Strategjik; E-mailin e datës 02.11.2020 nga _____ për _____ dhe Përgjigjen në ankesë e datës 27.04.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e pabazuar sepse:**

Bazua në provat e lëndës, emërimi i ankuesit në pozitën Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, është bërë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore për emërimin e nëpunësve civil të kategorisë së lartë drejtuese, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publikë në pajtim me nenin 83 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton që: *“Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore, i emëruar në këtë pozitë sipas procedurës së Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojë mandatin e tij/saj për kohën e mbetur të përcaktuar në Ligjin e Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës”*, rrjedhimisht ankuesit pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë e ka ushtruar deri më datë 23.11.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke ju referuar dispozitave ligjore të aplikueshme, konstaton se pas përfundimit të mandatit të ankuesit si Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë respektivisht pas kërkesës së tij për sistemim të datës 16.02.2021, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme në pajtim me kompetencat e tij të përcaktuar me nenin 11 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka ndërmarr veprime për emërimin e ankuesit në pozitë të mesme drejtues, ku me Vendimin me Nr. 199/2021 të datës 11.03.2021 është emëruar në pozitën Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshëm në Inspektoratin e Punës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.



Bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se emërimi i ankuesit në pozitën Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshëm në Inspektoratin e Punës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është bërë duke ju referuar dispozitave të nenit 42 paragrafit 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *“Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale”*, dhe nenit 15 paragrafit 1 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: *“Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit, DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore e emëron nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit se me emërimin në këtë pozita është dëmtuar në karrierë sepse pozita që më është ofruar nuk i përket përgatitjes sime profesionale, ka konstatuar se Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht Rregullorja Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues nuk ka paraparë kriteret për emërim të nëpunësve të kategorisë së lartë drejtuese, rrjedhimisht refuzimi për t’u emëruar në pozitë të mesme drejtuese përbën shkak për lirim nga Shërbimi Civil dhe përfundim të marrëdhënies së nëpunësit siç parashihet me nenin 15 paragrafi 1 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: *“Refuzimi për t’u emëruar në pozitën e nivelit të mesëm drejtues ose profesional është shkak për lirim nga Shërbimi Civil dhe përfundimin e marrëdhënies së punës të nëpunësit”*, mbi bazë të kësaj pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR.259/2021

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Eshref Shabani
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.